



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	14.07.2026
01 NR/BR.	192/26
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës z. Agim Aliu
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim-Vendim për miratimin e plotësim- ndryshimin e Strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Planit të Veprimit 2024-2027.

Në bazë të nenit 58 pika 1. h. të Ligjit, Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës bënë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Propozim-Vendim për miratimin e plotësim-ndryshimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Planit Komuna për Rini në Komunën e Ferizajt 2024-2027.

ARSYETIM

Me anë të këtij propozim-vendimi për miratimin e plotësim-ndryshimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Planit Komunal për Rini në Komunën e Ferizajt 2024-2027 e cila do të plotësohet me shtojcën 2 e cila përbanën Integrimin e Agjendave "Rinia, Paqja dhe Siguria (YPS)" dhe "Gratë, Paqja dhe Siguria (WPS)" në Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt.

Agjenda Rinia, Paqja dhe Siguria (Youth, Peace and Security - YPS) përfaqëson një nismë globale që ka filluar në vitin 2015 me miratimin e Rezolutës 2250 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kjo rezolutë shënoi njohjen ndërkombëtare të rolit kyç që të rinjtë kanë në parandalimin e konflikteve, ndërtimin e paqes dhe proceset e rimëkëmbjes pas konflikteve. Kjo qasje u fuqizua më tej nga Rezoluta 2419 (2018) dhe Rezoluta 2535 (2020), të cilat theksuan nevojën për angazhim sistematik dhe institucional të të rinjve në qeverisje, siguri dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Agjenda YPS është konceptualizuar mbi pesë shtylla kryesore.

1. Shtylla e Pjesëmarrjes kërkon përfshirjen aktive të të rinjve në proceset e vendimmarrjes, negociimit të paqes, politikëbërjes dhe jetës shoqërore, duke siguruar që politikat dhe vendimet publike të reflektojnë realisht nevojat dhe zërin e tyre.

2. Shtylla e Mbrojtjes ka për synim garantimin e sigurisë fizike dhe psikologjike të të rinjve, parandalimin e dhunës, diskriminimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, me vëmendje të veçantë ndaj grupeve të cënueshme.
3. Shtylla e Parandalimit fokusohet në adresimin e shkaqeve strukturore të dhunës dhe konfliktit, duke përfshirë promovimin e të drejtave të njeriut, qasjen në arsim cilësor, mundësitë ekonomike dhe programe që ulin rrezikun e radikalizimit.
4. Shtylla e Partneritetit nxit bashkëpunimin ndër-institucional ndërmjet qeverive, organizatave të shoqërisë civile, rrjeteve rinore dhe komuniteteve të ndryshme, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar, për të siguruar qasje të koordinuar dhe efektive.
5. Përfundimisht, Shtylla e Shkëputjes dhe Riintegritetit synon mbështetjen e të rinjve që kanë qenë pjesë e grupeve të dhunshme ose të armatosura, duke u krijuar mundësi për rikthim të sigurt dhe produktiv në shoqëri përmes arsimit, punësimit dhe shërbimeve sociale.

Në mënyrë paralele, Agjenda Gratë, Paqe dhe Siguri (Women, Peace and Security, WPS), e formalizuar fillimisht me Rezolutën 1325 të vitit 2000, përqendrohet në fuqizimin, mbrojtjen dhe garantimin e rolit aktiv të grave dhe vajzave në kontekstet e konfliktit dhe post-konfliktit. Kjo agjendë adreson në mënyrë të veçantë dhunën seksuale gjatë konflikteve dhe promovon përfshirjen e grave në proceset e paqes, negocime, rindërtim dhe vendimmarrje politike.

Rezolutat e mëvonshme, si 1820, 1888, 1960, 2106 dhe 2122, kanë zgjeruar kuadrin normativ të WPS duke theksuar përgjegjshmërinë institucionale, parandalimin e shkeljeve të të drejtave të grave dhe ofrimin e mbështetjes së specializuar për viktimat e dhunës. Shtyllat kryesore të WPS përfshijnë:

1. Pjesëmarrjen e grave në proceset e paqes dhe qeverisjes;
2. Mbrojtjen nga dhuna e ndërlidhur me konfliktin, përfshirë dhunën seksuale;
3. Parandalimin e shkeljeve të të drejtave të grave; si dhe
4. Ndihmën dhe rimëkëmbjen, që siguron qasje në shërbime shëndetësore, psikologjike, juridike dhe në programe socio-ekonomike të rehabilitimit.

Anëj kërkoj nga Kuvendi si i tillë të miratohet ky Propozim -Vendim.